

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**ACM21 sh.p.k.**

Ortaku themelues i Shoqërisë:

1. Znj. Alma Kaçi, lindur me 13/03/1983 ne Berat, e identifikuar me karten e identitetit numer personal I35313066B,

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, mbledhur sot më datë 12 Korrik 2021,

**VENDOSA**

**Neni 1**

Të themelojmë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtarinë tregtare ekonomike të emëruar “ACM21” sh.p.k..

**Neni 2**

Shoqëria do të jetë e formës së shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.) dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të derdhur në kapitalin themelor.

**Neni 3**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Haxhi Dushku, Nd nr. 7, Njesia Administrative Farke, Tirane. Me vendim te organit administrativ shoqëria mund të krijojë dhe suprimojë seli sekondare, agjensi, zyra dhe filiale edhe tjetërkund ndërkohë që për krijimin dhe suprimimin e tyre jashtë shtetit është e nevojshme vendimarrja e ortakeve me mbledhje të asamblesë.


**Neni 4**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar. Megjithatë, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin në fuqi.

**Neni 5**

Kapitali fillestar themelor i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetëmijë) lekë. Ortaku Alma Kaçi zotëron një kuotë me vlerë 10.000 (dhjetemije) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyera dhe të nënshkruara nga ortakët themelues të shoqërisë.

*Alma Kaçi*  


Neni 6

Shoqëria ka si objekt veprimtarite që vijojnë me poshte:

1. Sherbime konsulence për biznese të treta.
2. Sherbime menaxheriale për biznese të treta.

Neni 7

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit të saj.

Neni 8

Administrator i shoqërisë do të jetë znj. Alma Kaçi e identifikuar me kartën e identitetit numer personal I35313066B.


Modalitete për ndryshimin e administratorit si edhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqërisë, ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe ligji 131/2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”.

Ky Akt themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Datë 12 Korrik 2021

ORTAKU THEMELUES

Znj. Alma Kaçi



**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ACM21 sh.p.k.**

Neni 1

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar emërtuar "ACM21" sh.p.k..

Neni 2

1. Shoqëria ka selinë ligjore në adresën Rruga Haxhi Dushku, Nd nr. 7, Njesia Administrative Farke, Tiranë.
2. Transferimi i selisë brenda të njëjtës Bashki mund të vendoset nga organi administrativ.
3. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të krijojë dhe suprimojë agjensi, zyra dhe filiale edhe tjetërkund, ndërkohë që për krijimin dhe suprimimin e tyre jashtë shtetit, krijimin e selive sekondare si në Shqipëri dhe jashtë saj si edhe për transferimin e selisë së shoqërisë në rrethe të tjera, është e nevojshme vendimarrja e ortakëve në mbledhje të asamblesë.

Neni 3

Shoqëria ka si objekt veprimtarite që vijojne me poshte:

1. Shërbime konsulence për biznese të treta.
2. Shërbime menaxheriale për biznese të treta.

Neni 4

Shoqëria ka kohëzgjatjen e saj të pakufizuar.

Neni 5

Kapitali fillestar themelor i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetëmijë) lekë, i cili është i nga kontributi në para i ortakut znj. Alma Kaçi e cila zotëron një kuotë me vlerë 10.000 (dhjetëmije) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë. Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyera dhe të nënshkruara nga ortakët themelues shoqërisë.

Neni 6

1. Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Trashëgimtari hyn në shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut dhe me të gjitha efektet.
2. Të gjitha pjesët e kapitalit të Shoqërisë, mund t'u kalojnë të tretëve, vetëm nëse më parë respektohet e drejta e parablerjes së ortakut ekzistues. Në zbatim të këtij detyrimi, ortakut që kërkon të transferojë plotësisht apo pjesërisht pjesët e tij, duhet që më parë t'ia ofrojë me të njëjtat kushte ortakut ekzistues. Vetëm në rast refuzimi prej tij, atëherë pjesët mund t'u transferohen personave të tretë.

Neni 7


Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themelor, si edhe kapitale të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortakët e shoqërisë.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë do të administrohet sipas vendimarrjes së ortakëve të shoqërisë. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyej të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

Neni 9

Alma Kaçi



Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje të tilla si: shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndryshimeve në statut, zvogëlimi i kapitalit themelor ose zmadhimi i tij, transferimi i pjesëve të kapitalit themelor tek të tretët, të veprimtarisë së shoqërisë apo likujdimi i saj, shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër të parashikuar nga ligji, ndryshimi i vendndodhjes së selisë, si edhe ndryshimi i objektit të aktivitetit të shoqërisë, përcaktimin e orientimeve kryesore të programit dhe buxhetit, aprovimin e planeve dhe të llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në bazë të objektit të aktivitetit të shoqërisë.

#### Neni 10

Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga secili prej ortakëve. Thirrja e saj mund të bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi por edhe me mjete elektronike. Njoftimi me mjete elektronike bëhet në adresat e postës elektronike që secili prej ortakëve i depoziton në selinë e shoqërisë dhe që administrohen nga Administratori. Mbledhjet e asamblesë mund të zhvillohen edhe nëpërmjet mjeteve elektronike të cilat sigurojnë lehtësi komunikimi dhe besueshmëri. Në këtë rast, administratori përgjigjet për mirëfunksionimin e mjeteve dhe garantimin e zhvillimit të mbledhjes. Vendimet e asamblesë mund të jenë edhe dokumenta elektronikë dhe nënshkruhen nga ortakët elektronikisht.

#### Neni 11

Administratori qendron për një periudhë 5 (pesë) vjeçare në detyrë. Mandati i tij mund të jetë i rinovueshëm. Asambleja gëzon të drejtën që në çdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin dhe të emërojë një tjetër në vend të tij. Administratori mundet që në çdo moment të emërojë një zëvendës, ta revokojë dhe të emërojë një tjetër në vendin e tij. Administratori ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që i atribuohen asamblesë së përgjithshme në kuptim të ligjit dhe këtij statuti.

#### Neni 12

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar të cdo viti dhe përfundon me 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë, ku si fillim është data e rregjistrimit të shoqërisë.

#### Neni 13

Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratoret, apo nga ekspertët kontabel miratohen nga ortakët. Miratimi i dokumentave financiare vjetore bëhet brenda një afati 3-mujor të mbylljes së vitit financiar.

#### Neni 14

Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit, shoqëria mund të krijojë dhe fonde të tjera. Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhies së sigurimeve shoqërore, etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë bankave të vendit dhe të kryejë veprime likujdimi me to.

#### Neni 15

Marrëdhëniet e punësimit të shoqërisë rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në përputhje me Kodin e Punës, si edhe me legjislacionin tjetër shqiptar në fuqi.

#### Neni 16

Alma Krasni



Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë si dhe me persona fizikë ose juridik, vendas ose të huaj. Në veprimet kontraktuale Shoqëria përfaqësohet nga Administratori i saj. Të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për Shoqërinë.

#### Neni 17

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit të momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likujdatorë të cilët ndjekin operacionet e likujdimit deri në fund dhe i paraqesin ortakëve dhe administratorit rezultatet përfundimtare të likujdimit. Në përfundim ortakët vendosin për heqjen e mandatit të tyre. Të gjitha detyrimet që dalin nga likujdimi, ortakët i marrin përsipër për t'i shlyer me kapitalin e shoqërisë.

#### Neni 18

Themeluesit e shoqërisë mund të bëjnë ndryshime ose plotësime në statut dhe në aktin e themelimit, pa rënë ndesh në mënyrë thelbësore me nenet e këtij statuti, në cdo kohë. Ndryshimet e plotësimet bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vet statuti.

#### Neni 19

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky statut është përpiluar dhe firmosur në 3 (tre) kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Date 12 Korrik 2021

ORTAKU THEMELUES

Alma Kaçi

